



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 786/2 Prot

Tiranë, më 23.11.2020

V E N D I M

Nr. 154, datë 23.11.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, për verifikimin e ligjshmërisë së zhvillimit të procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë, me kod #3068, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Ankimimeve, (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)”, në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, në institucionin Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet e ngritura nga nëpunësja *****, për parregullsi në procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë, me kod #3068,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të paraqitur nga nëpunësja *****, protokolluar me nr.786 prot., datë 15.10.2020 ngrihen pretendime për veprime të kryera/lejuara gjatë fazës së kualifikimit në procedurën e konkurrimit me kod #3068, “Shpallje për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese”, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Ankimimeve, (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)”, në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, të cilat vijnë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Në përfundim të procesit të verifikimit të kërkesës së mësipërme, konstatohet që kandidatja *****, përmes portalit *online* të Departamentit të Administratës Publike, në datën 24.09.2020, brenda afatit të caktuar, ka aplikuar për të marrë pjesë në konkurrimin për ngritje në detyrë, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Ankimimeve, (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)”, në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Në vijim, pas aplikimit, në datën 06.10.2020, ankuesja nëpërmjet e-mailit është njoftuar nga ana e DAP, se nuk është kualifikuar për fazat e mëtejshme të konkurrimit pasi mungonte lista e notave të masterit profesional, që të vërtetonte plotësimin e 120 krediteve në Shkenca Juridike, që kërkohej në kriterin e vendosur në shpalljen për konkurrim, të Departamentit të Administratës Publike.

Sa më sipër, kërkuesja ***** ngre pretendimin se, pretendimi i mësipërm nuk është i drejtë pasi në dokumentacionin e paraqitur për konkurrim prej saj, janë depozituar edhe diplomat të cilat provojnë se zotëron dy master, një master profesional në të Drejtën Civile, dhënë nga Fakulteti, i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe një master shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare, dhënë nga departamenti i Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Universiteti “*Ismail Qemali*”, Vlorë.

Gjithashtu, ajo e konsideron të padrejtë konkluzionin e njësisë së paraseleksionimit që masteri shkencor i marrë në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, të Universitetit “*Ismail Qemali*”, Vlorë, nuk është në përputhje me kërkesat e konkurrimit, pasi nuk është master në shkenca juridike.

Kërkuesja pretendon se, masteri shkencor ka pasur në program vetëm lëndë juridike, është dhënë nga departamenti i Drejtësisë, të fakultetit të Drejtësisë të Universitetit “*Ismail Qemali*”, Vlorë dhe njihet si diplomë në Shkenca Juridike. Për më tepër, sipas saj ky master i jep të drejtën mbajtësit, të ndjekë shkollën e avokatisë për tu pajisur me licensën e avokatisë.

Në këto kushte, duke mos qenë dakort me vendimin për skualifikimin për fazat e mëtejshme të konkurrimit, kërkuesja *****, ka paraqitur ankim pranë Departamentit të Administratës Publike, i cili është protokolluar me nr. 4670 prot., datë 06.10.2020, nga ky i fundit, për të cilën pretendon se nuk ka marrë ende një përgjigje, prandaj i është drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për të ndërhyrë për konstatimin e shkeljeve kryera gjatë kësaj faze të konkurrimit dhe rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në zbatim të kompetencave të ngarkuara nga ligji.

Në vijim, Komisioneri pasi u njoh me parashtrimin e fakteve të mësipërme dhe me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja ***** përmes e-mailit zyrtar të datës 22.10.2020, kërkoi nga ankuesja informacion më të detajuar në lidhje me identifikimin e procesit të konkurrimit të zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, për të cilin ngrinte pretendimet e saj për parregullsi, me qëllim kërkimin dhe administrimin më pas të praktikës shkresore që materializonte procedurën e ndjekur në këtë rast konkurrimi, duke përfshirë çdo dokumentacion pjesë të kësaj praktike, nga DAP, e mbi këtë bazë verifikoi online, në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, procedurën e ndjekur përmes shpalljeve të publikuara për konkurrimin me kod #3068.

Nga verifikimi rezultoi se, Departamenti i Administratës Publike, pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga konkurrentja në fjalë (*ankesa me nr. 4670 prot., datë 06.10.2020*), ka rivlerësuar dokumentacionin e paraqitur prej saj, duke e pranuar atë. Në vijim, përmes shpalljes “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit për ngritje në detyrë në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese*” kandidatja *****, është njoftuar se është kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Ankimimeve, (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)*”, në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kategoria III-a/1, duke e zgjidhur në këtë mënyrë mosmarrëveshjen.

Në përfundim, nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se pretendimi i ankueses *****, për shkelje të kryera dhe lejuara gjatë fazës së kualifikimit në procedurën e konkurrimit me kod #3068, nga ana njësisë përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, është marrë parasysh nga ky i fundit, duke rishikuar vendimin e tij dhe pranuar këtë konkurrençe për të vijuar në fazat e mëtejshme të konkurrimit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të ankesës nr. 786 prot., datë 15.10.2020, të paraqitur nga nëpunësja *****, për parregullsi në procedurën administrative për ngritje në detyrë, përmes shpalljes me kod #3068, nga ana njësisë përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, pasi çështja nuk ka më objekt dhe arkivimin e saj.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha